

**Vendim nr. 22 datë 30.01.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Marjana Semini, Anëtare

në datën 30.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **SAMI SHTËPANI**, përfaqësuar nga avokate Gjystina Golloshi, me prokurë.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3304, datë 11.04.2008 dhe nr. 1888 akti, datë 19.01.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 244, datë 08.09.2009 dhe nr. 520, datë 09.09.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 dhe nr. 00-2024-3372, datë 24.07.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.  
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 15, 18, 37, pika 1, 41, pika 2, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Sami Shtëpani ka bashkëjetuar me prindërit, vëllezërit, motrat dhe bashkëshorten në një apartament prej 118 m<sup>2</sup>, i cili në bazë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, nëpërmjet kontratës së privatizimit të vitit 1993, ka kaluar në pronësi të tyre në pjesë të barabarta nga 1/7-ta pjesë për secilin.

2. Në datën 03.12.1997 kërkuesi dhe bashkëshortja e tij F.Sh., nëpërmjet kontratës së dhurimit, i kanë kaluar pjesët e tyre takuese të pronësisë mbi apartamentin shtetasit R.Sh.(babait të kërkuesit). Në vijim, në datën 06.05.2006, R.Sh., nëpërmjet dëshmisë testamentare, ka emëruar kërkuesin si trashëgimtar të vetëm testamentar të tij në 1/5-ën pjesë takuese të apartamentit prej 118 m<sup>2</sup>.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi kanë ndërruar jetë trashëgimlënësit Z.Sh. dhe R.Sh. (prindërit e kërkuesit), me kërkesë të shtetasit A.Sh. (i biri i trashëgimlënësve dhe vëllai i kërkuesit), me vendimin nr. 3304, datë 11.04.2008, ka lëshuar dëshmitë e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësve Z.Sh dhe R.Sh. Në pamundësi të pjesëtimit vullnetar, shtetasit A.Sh. dhe F.Sh. (vëllai dhe motra e kërkuesit) i janë drejtuar përsëri asaj gjykate me kërkesë për pjesëtim pasurie të paluajtshme në bashkëpronësi.

4. Me vendimin nr. 1888 akti, datë 19.01.2009, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pjesëtimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 118 m<sup>2</sup> të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8150 Tiranë, të regjistruar me nr. vol. 11, faqe 112, datë 19.11.2008, midis bashkëpronarëve: F.Sh. me 251/1050 pjesë ideale, A.Sh. me 251/1050 pjesë ideale, B.Sh. me 251/1050 pjesë ideale, S.Sh. me 101/1050 pjesë ideale dhe kërkuesi me 196/1050 pjesë ideale të pasurisë (të përbërë nga 1/42-ta pjesë e trashëguar nga nëna e tij nëpërmjet trashëgimisë ligjore, 19/210-ta pjesë e trashëguar sipas disponimit të pjesshëm me testament të pasurisë së babait të tij, si dhe 76/1050 pjesë e trashëgimisë ligjore të pjesës së babait të tij). Mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr. 244, datë

08.09.2009, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Mbi rekursin e kërkuetit, me vendimin nr. 00-2013-2275 (564), datë 17.10.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se ajo gjykatë ka gabuar në përcaktimin e pjesëve takuese të secilit bashkëpronar, si dhe nuk ka vendimmarrje të arsyetuar, duke lënë si detyrë zhvillimin e një hetimi më të plotë mbi dokumentacionin e palëve.

5. Gjykata e Apelit, pas rigjyimit, me vendimin nr. 520, datë 09.09.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, me arsyetimin se i është dhënë përgjigje detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkueti në datën 09.10.2014 dhe kundërrekurs pala paditëse në procesin gjyqësor. Me vendimin nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

6. Kërkueti ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë kërkesën me nr. 3567/2 prot., datë 11.11.2016, me objekt rishikimin e vendimit civil nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 të asaj gjykate, duke pretenduar se trashëgimlënësit i kanë lënë kërkuetin një testament, duke e caktuar trashëgimtar testamentar me pasuri vetjake të tij prej 3/7-at të apartamentit të ndodhur në rrugën “Beqir Luga”, Tiranë, i cili, sipas tij, nuk është njohur nga gjykatat. Gjithashtu, kërkueti ka pretenduar se trupi gjykues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit ka marrë pjesë dhe ka dhënë vendime të tjera po në dhomën e këshillimit të po kësaj gjykate, me po të njëjtat palë ndërgjyqëse të familjes së trashëgimlënësit R.Sh. dhe se vendimi për të cilin pretendohet rishikimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë, të dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

7. Me vendimin nr. 00-2024-3372, datë 24.07.2024 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 të asaj gjykate, pasi nuk plotësoheshin kushtet e përcaktuara nga neni 494 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8. Në datën 25.11.2024 kërkueti i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### **Pretendimet e kërkuessit**

9. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë kanë marrë vendime të padrejta në kundërshtim me ligjin. Gjykata e Lartë, në shkëlqje të nenit 494, shkronja “e”, të KPC-së, nuk ka pranuar rishikimin e vendimit të saj nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016, i cili është në kundërshtim me një vendim tjetër të formës së prerë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak (vendimi nr. 00-2013-2275 (564), datë 17.10.2013 i Gjykatës së Lartë). Po kështu, gjykata e apelit, në shkëlqje të nenit 467/b të KPC-së, duhet të konstatonte parregullsitë në vendimin nr. 1888, datë 19.01.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin evidentohet firma e vetëm njërit prej anëtarëve të trupit gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë dhe ta dërgonte çështjen për rigjykim në shkallë të parë.

### **III**

#### **Vlerësimi i Kolegjit**

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neni 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë

ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

12. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tij për rishikimin e vendimeve të tjera objekt kërkimi, ndaj të cilit nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, ndaj ai ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

15. Kolegji vëren se kërkuesi në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar gjithsej 5 (pesë) vendime gjyqësore, konkretisht: vendimin nr. 00-2024-3372, datë 24.07.2024 të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për rishikimin e procesit gjyqësor të përmbyllur me vendimin nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 të po asaj gjykate, si edhe 3 (tre) vendime të tjera gjyqësore (objekt kërkimi), përmes të cilave gjykatat e faktit (2 vendime të gjykatës së shkallës së parë dhe një vendim të gjykatës së apelit) kanë shqyrtuar dhe rishqyrtuar çështjen e tij për pjesëtimin e pasurisë. Për sa i takon procesit gjyqësor të përmbyllur me vendimin nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se kërkuesi e ka kundërshtuar atë para Gjykatës pas më shumë se 8 vjetësh nga disponimi i tij. Thënë kjo, kërkuesi, ndonëse ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike në dispozicion, sipas parashikimeve dhe afateve ligjore në fuqi në atë kohë, nuk ka paraqitur ankim kushtetues individual në kohën e duhur. Për rrjedhojë, lidhur me pretendimet për parregullsinë e procesit gjyqësor të përmbyllur me vendimin nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 të Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*.

16. Ndërsa, lidhur me pretendimet që i referohen vendimit nr. 00-2024-3372, datë 24.07.2024, të Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi

ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, sipas përcaktimeve të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

17. Për sa i përket legjitimit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 00-2024-3372, datë 24.07.2024 i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së pronës private, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, mbështetur në dy argumente thelbësore që lidhen, i pari me faktin se testamenti përbën provë të re dhe të mjaftueshme për rishikimin e procesit dhe i dyti se Gjykata e Lartë, në shkelje të nenit 494, shkronja “e”, të KPC-së, nuk ka pranuar rishikimin e vendimit nr. 00-2016-2509, datë 23.09.2016 të asaj gjykate, i cili është në kundërshtim me një vendim tjetër të formës së prerë midis po këtyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak (*shih vendimin nr. 00-2013-2275 (564), datë 17.10.2013 të Gjykatës së Lartë*).

18. Kolegji rithekson se rishikimi përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjete ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 36, datë 26.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e

gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se argumenti që lidhet me faktin se testamenti përbën provë të re është parashtruar nga kërkuesi edhe në shkaqet e kërkesës për rishikim. Kjo e fundit është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila është shprehur se testamenti apo dëshmia e trashëgimisë testamentare janë bërë objekt shqyrtimi edhe më parë, pasi shqyrtimi i këtij testamenti ka qenë një nga arsyet pse Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2013-2275 (564), datë 17.10.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 244, datë 08.09.2009 të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues (*shih paragrafin 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në analizë të argumentimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se nuk ka arsye për të vënë në dyshim vlerësimin e saj.

21. Gjithashtu, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë e ka vlerësuar si të pambështetur edhe argumentin tjetër të kërkuesit se vendimi për të cilin kërkohet rishikimi është në kundërshtim me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë po nga ajo gjykatë, midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Konkretisht, sipas saj, kërkuesi bashkëlidhur kërkesës ka paraqitur disa vendime të Gjykatës së Lartë, të cilat lidhen kryesisht me akuza penale dhe gjykime të urdhrave të mbrojtjes, midis palëve në këtë gjykim, të cilat nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara nga shkronja “e” e nenit 494 të KPC-së (*shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kjo do të thotë se Gjykata e Lartë në përmbushje të detyrimeve të saj kushtetuese dhe ligjore, si gjykatë ligji, pasi ka analizuar shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në kërkesën për rishikim, i ka dhënë atij përgjigje të arsyetuar lidhur me to.

22. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kjo mënyrë e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë qenë arbitrare, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt nga Gjykata e Lartë gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar për shqyrtimin e kërkesës së tij për rishikim, është haptazi i pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.